



KRYETARI

Nr. prot. 14859

Tiranë më 6/5/2016

Drejtuar: Z. Aldrin Dalipi
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës

Lënda: Dërgohet projekt - vendim dhe relacion për shqyrtim dhe miratim

I nderuar z. Dalipi,


Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin dhe relacionin për "Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës".

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Erion Veliaj





KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

VENDIM (projekt)

Nr. _____, datë _____

për

“Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 shkronja “ç”, nenin 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr.152/2013 “ Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); ligjit 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; he vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nivelin e pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrative të Bashkisë së Tiranës si dhe punonjësit e Policisë Bashkiake sipas lidhjeve nr.1, 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Maj të vitit 2016 dhe do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Financës.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.50, datë 11.11.2015 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave në Bashkinë e Tiranës”, revokohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Aldrin Dalipi

KRYETAR

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

EMËRTIMI	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia ne %	Shtesa për pozicion
Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	174 760
Zv/Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	140 000
Administrator i Përgjithshëm	I	b	1	2%	118 000
Drejtor i Kabinetit	II	a	1	2%	107 800
Sekretar i Këshillit Bashkiak	II	a	1	2%	107 800
Drejtor i Përgjithshëm	II	a	1	2%	107 800
Këshilltar në Kabinet	II	b	1	2%	91 700
Drejtor Drejtorie	II	b	1	2%	91 700
Përgjegjës Sektori	III	a	1	2%	74 400
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	65 200
Përgjegjës Zyre	III	b	1ose 2	2%	57 000
Specialist I	III	b	1ose 2	2%	57 000
Specialist II	IV	a	1ose 2ose 3	2%	45 800
Specialist III	IV	b	1ose 2ose 3	2%	35 500
Sekretar i kryetarit	IV	a	1ose 2ose 3	2%	45 800

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi ne %
1	Specialist me arsim te mesëm (kontrata) , Sekretare	V	36 500	1%
2	Magaznier	IV	36 500	1%
3	Punonjës shërbimi, Receptionsist	III	34 000	1%
4	Shofer	II	32 000	1%
5	Pastruese	I	31 000	1%

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 2 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën baze të klasës së I.

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Nr	Emërtimi	Paga
1	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	91 000
2	Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	69 150
3	Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	52 500
4	Inspektor i Policisë Bashkiake në Njesite Administrative deri në 20 000 banorë	43 000
5	Punonjës i Policisë Bashkiake ne Njesite Administrative deri në 20 000 banorë	41 000



BASHKIA E TIRANËS
Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

RELACION

për

“Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës”

Në mbështetje të të nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 shkronja “ç”, nenin 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr.152/2013 “ Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); ligjit 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; he vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” Drejtoria e Pergjithshme e Menaxhimit Financiar propozon për miratim lidhjet e pagave për punonjësit e Bashkisë së Tiranës si më poshtë :

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016, për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, është bërë rigrupimi i pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për këtë arsye është e nevojshme që Këshilli Bashkiak të miratojë nivelin e pagave të përcaktuara në këtë VKM sipas lidhjeve të më poshtë:

Në Lidhjen Nr.1 përcaktohet paga për funksionet e zgjedhura dhe të emëruara, paga e grupit, vjetërsia dhe shtesa për pozicion për nëpunësit civilë të Bashkisë së Tiranës sipas klasave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

E M E R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia në %	Shtesa për pozicion
Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	174 760
Zv/Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	140 000
Administrator i Përgjithshëm	I	b	1	2%	118 000
Drejtor i Kabinetit	II	a	1	2%	107 800

Sekretar i Këshillit Bashkiak	II	a	1	2%	107 800
Drejtor i Përgjithshëm	II	a	1	2%	107 800
Këshilltar në Kabinet	II	b	1	2%	91 700
Drejtor Drejtorie	II	b	1	2%	91 700
Përgjegjës Sektori	III	a	1	2%	74 400
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	65 200
Përgjegjës Zyre	III	b	1ose 2	2%	57 000
Specialist I	III	b	1ose 2	2%	57 000
Specialist II	IV	a	1ose 2ose 3	2%	45 800
Specialist III	IV	b	1ose 2ose 3	2%	35 500
Sekretar i kryetarit	IV	a	1ose 2ose 3	2%	45 800

Në Lidhjen Nr.2 propozohet niveli i pagës për punonjësit administrativ bazuar në pikën 19 dhe 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.169, datë 02.03.2016, në të cilën përcaktohet paga bazë si dhe shtesa për vjetërsi në masën 1 % deri në 25 vjet punë.

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit administrativ

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi ne %
1	Specialist me arsim te mesëm (kontrata) , Sekretare	V	36 500	1%
2	Magaznier	IV	36 500	1%
3	Punonjës shërbimi, Receptionist	III	34 000	1%
4	Shofer	II	32 000	1%
5	Pastruese	I	31 000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 2 jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën baze të klasës së I.

Në Lidhjen Nr.3 propozohet niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake bazuar në Lidhjen nr. 5 të VKM-së nr.586, datë 17.07.2013 për “Disa ndryshime në vendimin nr. 1619 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar”

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Nr	Emërtimi	Paga
1	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	91 000
2	Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	69 150
3	Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	52 500
4	Inspektor i Policisë Bashkiake në Njesite Administrative deri në 20 000 banorë	43 000

Aplikimi i pagës sipas lidhjeve të mësipërme do të fillojë nga data 1 Maj 2016 dhe efektet financiare të rritjes së pagave do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë sa kemi parashtruar në këtë relacion, ju paqesim për miratim nivelin e pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrative të Bashkisë së Tiranës si dhe punonjësit e Policisë Bashkiake.

Duke shpresuar në miratimin e këtij projekt -vendimi nga ana Juaj.

Drilona Aliko
Specialist i Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Arba Isaj
Përgjegjës i Sektorit të Zbatimit të Buxhetit

Anisa Seferaj
Drejtori i Drejtorisë Juridike

Jonida Halili
Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar

Itena Ndroqi
Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licensimit

Keti Luarasi
Drejtor i Përgjithshëm i Burimeve Njerëzore

Arbjan Mazniku
Zv. Kryetar

Arsela Gjonaj
Juristi i Këshillit Bashkiak

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak